



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1109/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Afijete Sada-Gllogjani kryesuese, Milena Đeric dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Agim Sahiti, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në komunën e Malishevës, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Malishevës, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.1109/2021 i datës 10.11.2021, i paraqitur nga Agim Sahiti, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në komunën e Malishevës, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Malishevës, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në Vendvotimet ne fshatin Mleqan VV 3001A/03D, në komunën e Malishevës.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 10.11.2021, ka pranuar apelin Anr.1109/2021 me datën 10.11.2021 (të dërguar përmes postës me datë 04.11.2021) të paraqitur nga Agim Sahiti, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në komunën e Malishevës, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Malishevës me të cilën pretendon se në vendvotimin ne fshatin Mleqan VV 3001A/03D, në komunën e Malishevës dyshon se i është shkelur e drejta gjatë numërimit të votave sepse në bazë të dëshmive të tij numri i votave për të është më i madh. Andaj ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimin e pretenduar si në apel. Si dëshmi krahas apelit ka bashkangjitur nje kopje te letërnjoftimet dhe një kopje te nje pasaporte.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga Agim Sahiti, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në komunën e Malishevës, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Malishevës me të cilën kërkon rinumërim të votave në fshatin Mleqan, në Vendvotimin VV 3001A/03D, në komunën e Malishevës është i pabazuar pasi që Paneli vlerëson se parashtruesi e apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Paneli me rasti e vendosjes mori për bazë pretendimet e ankuesit se në vendvotimin 3001A/03D, ka pasur më shumë vota duke mos precizuar se sa vota pretendon ti ketë marre, ndërsa si prove ka ofruar vetëm kopjet e dokumenteve personale – letërnjoftimet e dy personave (votuesve të pretenduar) për panelin është e qartë se në këtë vendvotimin kandidati në fjalë ka pas gjithsej 6 vota dhe të njëjtat vota janë publikuar me rastin e publikimit të rezultatit përfundimtar, por me asnjë provë shkresore ankuesi në vendvotimin e vendosur si në dispozitiv nuk i ka argumentuar se ka pasur me shume vota ose qe ka pasur parregullsi me rastin e publikimit të rezultatit të publikuar në rezultatin përfundimtar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.1109/2021 më datën 11.11.2021

Kryesuesja e Panelit
Afijete Sada Gillogjani

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti që marrëveshjen pranimit të këtij vendimi.

